
AKT THEMELIMI

"KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë **"KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë

Ortak i Vetëm i shoqërisë është: **Z. Shefqet KASTRATI**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.06.1961, banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. personal G10605213B, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Aktivitet në fushën e aviacionit civil;**
- **Projektim, investim, ndërtim, administrim dhe menaxhim/operim i terminaleve dhe aeroporteve të aviacionit civil e jo vetëm, të strukturave, faciliteteve si dhe realizimi i të gjitha shërbimeve të lidhura me industrinë e aviacionit pa asnjë përjashtim;**
- **Blerje, shitje, dhënie apo marrje me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të lidhura me industrinë e aviacionit;**
- **Operimi dhe menaxhimi i linjave të aviacionit civil vendase dhe/ose të huaja;**
- **Ofrimi i asistencës dhe konsulencës teknike, ligjore, financiare, administrative dhe shërbime të tjera të ligjshme të çdo lloji (pa kufizim), përfshirë trajnime për rritjen e efektivitetit dhe sigurisë teknike dhe jo vetëm në sektorin e aviacionit civil dhe sektorët e tjerë që kanë lidhje me operimin e strukturave dhe faciliteteve të aviacionit civil, duke përfshirë aeroportet;**
- **Në lidhje me aktivitetin në fushën e aviacionit civil, shoqëria organizohet dhe funksionon si një shoqëri HOLDING, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin tregtar të**



shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja. Në këtë aspekt shoqëria mund të koordinojë, organizojë, kontrollojë dhe menaxhojë në cilësinë e shoqërisë HOLDING, në aspektin ligjor, teknik, administrativ, financiar dhe strukturor të gjitha shoqëritë e grupit dhe/ose shoqëri të tjera që veprojnë në industrinë e aviacionit civil, duke krijuar për këtë qëllim borde të centralizuara menaxhimi dhe administrimi si dhe duke ofruar shërbime të këshillimit financiar, teknik, zhvillimit strategjik, zhvillimit të biznesit etj.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100.000 (njëqind mijë lekë).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:



-
- Asambleja e Ortakëve.
 - Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administrator i parë i shoqërisë është: **Znj. Eda Spahiu**, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 19.09.1989, e identifikuar nga karta e identitetit me nr. 034021305 dhe nr. personal I95919043R.

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM

Shfaqet KASTRATI


[emër, mbiemër, firmë]

Datë 11.04.2022